FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.147 22 tetor 2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.960, datë 18.9.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.115, datë 2.2.2009 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2009, në disa ministri dhe institucione qendrore", të ndryshuar	6591
Udhëzim i MB nr.656, datë 6.10.2009	Për procedurat e certifikimit, licencimit dhe kontrollit të veprimtarisë së shërbimit, të ruajtjes dhe sigurisë fizike	6592
Vendim i ERE nr.62, datë 15.9.2009	Për miratimin e rregullores "Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve"	6615
Vendim i ERE nr.63, datë 22.9.2009	Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë "E-Vento" srl Albania sh.p.k."	6621
Vendim i ERE nr.64, datë 22.9.2009	Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë "Union Eolica Albania "sh.p.k."	6622
Vendim i ERE nr.65, datë 22 .9.2009	Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve te vendosura nga ERE shoqërisë "Hera sh.p.k."	6622

VENDIM
Nr.960, datë 18.9.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.115, DATË 2.2.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2009, NË DISA MINISTRI DHE INSTITUCIONE QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr.115, datë 2.2.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2009, për ministritë dhe institucionet qendrore, është 2657 punonjës, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

2. Ngarkohet Ministria e Financave të miratojë shtesën në numrin e punonjësve me kontratë të përkohshme, sipas profesioneve dhe afateve kohore, brenda kritereve të përcaktuara në vendimin e sipërpërmendur.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Grupi	Emri institucionit	Nr.i punonjësve
02	Kuvendi i Shqipërisë	11
03	Këshilli i Ministrave	1
04	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	58
05	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	213
06	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	815
10	Ministria e Financave	50
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	113
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	22
13	Ministria e Shëndetësisë	51
14	Ministria e Drejtësisë	31
15	Ministria e Punëve të Jashtme	16
16	Ministria e Brendshme	582
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	40
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	30
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	87
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	140
28	Prokuroria e Përgjithshme	5
30	Gjykata Kushtetutese	2
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	4
50	INSTAT	378
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	2

77	Autoriteti i Konkurrencës	2
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	1
87	Institucione të tjera Qeveritare	2
	Total	**2656**

UDHËZIM
Nr.656, datë 6.10.2009

PËR PROCEDURAT E CERTIFIKIMIT, LICENCIMIT DHE KONTROLLIT TË VEPRIMTARISË SË SHËRBIMIT TË RUAJTJES DHE SIGURISË FIZIKE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të shkronjës "c" të nenit 7 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", neneve 15, pika 2, dhe 19 të ligjit nr.8770, datë 19.4.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike", të ndryshuar, të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Policia e Shtetit bën certifikimin e veprimtarisë së personave fizikë në fushën e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike (SHRSF) për:

a) drejtues teknik,

b) titullar subjekti,

c) punonjës shërbimi.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit përcakton me akt të veçantë krijimin, përbërjen dhe procedurat e funksionimit të këtyre komisioneve:

a) Komisionit të shqyrtimit të kërkesave për certifikim/licencim (KSHKC) në fushën e veprimtarisë së shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Departamentin e Sigurisë Publike dhe në drejtoritë e policisë në qarqe (DPQ);

b) Komisionit të testimit të njohurive profesionale (KTNP) të kandidatit për drejtues teknik dhe të punonjësit të shërbimit në Departamentin për Trajnimin Policor dhe në DPQ.

I
DOKUMENTACIONI PËR CERTIFIKIMIN E DREJTUESIT TEKNIK DHE TITULLARIT TË SHRSF-SË

3. Për t'u pajisur me certifikatën e drejtuesit teknik për veprimtarinë e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, kandidati paraqet në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH) këto dokumente provuese:

a) Autodeklarim "Për drejtuesin teknik", sipas formularit model 1, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi, i cili plotësohet në prani të pranuesit të dokumenteve.

b) Dokument identifikimi i njohur sipas legjislacionit në fuqi.

c) Vetëdeklarim "Për verifikimin e gjendjes gjyqësore", sipas formularit të modelit 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi, i cili plotësohet në prani të personit pranues.

d) Kopje diplome të noterizuar që vërteton përfundimin e arsimit të lartë policor ose ushtarak.

e) Vërtetim nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ose në Ministrinë e Mbrojtjes për periudhën e shërbimit në polici, gardë ose ushtri.

f) Raport nga komisioni mjeko-ligjor, që është i aftë nga ana e shëndetit fizik dhe mendor.

g) Fotografi të aplikuesit, 4 copë, me përmasa 4 x 6 cm.

4. Për t'u pajisur me certifikatën "titullar i subjektit", kandidati duhet të paraqesë në DPPSH këto dokumente provuese:

a) Autodeklarimi “Për titullarin e subjektit”, sipas formularit model 2, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi, i cili plotësohet në prani të pranuesit të dokumentacionit.

b) Certifikatë regjistrimi i subjektit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (biznesit).

c) Dokument identifikimi i njohur sipas legjislacionit në fuqi.

d) Vetëdeklarim “Për verifikimin e gjendjes gjyqësore”, sipas formularit model 5, i cili plotësohet në prani të pranuesit të dokumentacionit.

e) Fotografi të aplikuesit, 4 copë, me përmasa 4x6 cm.

f) Stema model e subjektit.

g) Raport nga komisioni mjeko-ligjor, që është i aftë nga ana e shëndetit mendor dhe fizik.

II
PROCEDURAT PËR PRANIMIN, VERIFIKIMIN DHE SHQYRTIMIN E DOKUMENTACIONIT

5. Për pranimin, verifikimin dhe shqyrtimin e dokumenteve për certifikim, të paraqitura sipas pikave 3 dhe 4 të këtij akti, nga specialistët përkatës, ndiqet kjo radhë pune:

a) Dokumentet paraqiten në DPPSH, te specialisti i ngarkuar me këtë detyrë, i cili kërkon nga subjekti plotësimin e formularëve përkatës, sipas rubrikave dhe në fund i nënshkruan ato edhe vetë, duke vërtetuar vërtetësinë e plotësimit të tyre nga kandidati.

b) Me marrjen në dorëzim të dokumentacionit sipas pikave 3, 4 dhe 17 të këtij udhëzimi pranuesi plotëson në dy kopje vërtetimin e pranimit të dokumenteve, sipas formularit model 4, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi, ku njërën ia bashkëlidh dokumentacionit dhe tjetrën ia jep aplikuesit.

c) Së bashku me vërtetimin model 4, aplikuesit i jepet një kopje e programit të testimit të njohurive profesionale.

d) Dokumentet e pranuara regjistrohen brenda ditës në sekretari dhe njëkohësisht nga specialisti përkatës përgatitet e dërgohet kërkesa për përpilimin e vërtetimit të besueshmërisë së kandidatit, sipas kërkesës së paraqitur, te drejtoria e policisë së qarkut (DPQ), në të cilën ndodhet vendbanimi i përhershëm i tij.

e) Vetëdeklarimi (për verifikimin e gjendjes gjyqësore) dërgohet me shkresë përcjellëse për verifikim te struktura e policisë e ngarkuar me këtë detyrë, duke sqaruar edhe arsyet e verifikimit.

f) Për drejtuesin teknik, bëhet kërkesa për testimin e njohurive profesionale.

6. Drejtoria e policisë së qarkut, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së kërkesës, dërgon vërtetimin e besueshmërisë pranë DPPSH-së, i cili përpilohet sipas rregullave e procedurave të përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

7. Komisioni i testimit të njohurive profesionale në Departamentin për Trajnimin Policor, në datën e përcaktuar mblidhet dhe zhvillon testimin vlerësues, duke vlerësuar nëse kandidati është ose jo i aftë nga ana profesionale për kryerjen e detyrës së drejtuesit teknik të SHRSF-së. Në përfundim, vlerësimin e dërgon menjëherë pranë KSHKC-së.

8. Komisioni i shqyrtimit të kërkesave për certifikim, ndërmjet datave 20-25 të çdo muaji, mblidhet dhe shqyrton dokumentacionin e grumbulluar nga sektori përkatës për pajisjen me certifikatë të titullarit të subjektit apo të drejtuesit teknik. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës ky komision përgatit mendimin paraprak dhe certifikatat sipas modelit tip 6 dhe 7, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe ia paraqet për miratim Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

9. Certifikatat përgatiten në dy kopje, njëra prej të cilave i jepet përkatësisht titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik, ndërsa kopja tjetër kundërfirmoset përkatësisht nga titullari dhe drejtuesi teknik. Këto administrohen së bashku me dokumentet që kanë shërbyer si bazë e dhënies së tyre në kartotekën (sekretarinë) e Departamentit të Sigurisë Publike.

10. Në rastet e refuzimit të dhënies së certifikatës së kërkuar, bëhet njoftimi me shkrim i personit të interesuar (aplikantit).

III
BASHKËRENDIMI I PUNËS ME QENDRËN KOMBËTARE TË LICENCIMIT

11. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, nëpërmjet strukturave të saj, pranon dhe shqyrton dokumentacionin për subjektet që kanë aplikuar për licencim në fushën e "shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike", pranë QKL, sipas përcaktimeve të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore e që rregullojnë këtë veprimtari.

12. Struktura përkatëse në DPPSH, pasi merr aplikimin nga QKL-ja, kryen procedurat për verifikimin e kërkesës së subjektit duke u bazuar në materialet që kanë shërbyer për dhënien e certifikatave për drejtues teknik dhe për titullarë të subjektit, si dhe, kur është e nevojshme apo kur ka kaluar një afat mbi 6 muaj nga lëshimi i tyre, kryen veprime të tjera shtesë verifikuese.

13. Shërbimet e Policisë së Shtetit në procesin e verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesës për t'u pajisur me certifikatë apo për licencimin e veprimtarisë së SHRSF-së, fokusohen kryesisht në përmbushjen e kriterit të besueshmërisë, të përshtatshmërisë.

Për rastet e kërkesave për përtëritje të licencës, kërkohet të bëhet vlerësimi i performancës dhe ligjshmërisë së aktivitetit të subjektit gjatë periudhës së mëparshme të licencimit.

14. Komisioni i krijuar sipas pikës 2.a të këtij akti, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe atë të grumbulluar nga struktura përkatëse, gjatë procesit të verifikimit e vlerësimit të veprimtarisë së subjektit përgatit mendimin paraprak dhe ia paraqet për miratim Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

15. Pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, vendimi përfundimtar i bëhet menjëherë i ditur QKL-së. Ky njoftim (përgjigje) duhet të bëhet brenda 60 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës nga QKL-ja.

16. Kur për shkaqe objektive nuk është e mundur dhënia e mendimit përfundimtar në afatin e përcaktuar, me qëllim që mos të ketë miratim të heshtur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë mund të kërkojë nga QKL-ja zgjatjen e afatit deri në 60 ditë të tjera.

IV
PROCEDURAT PËR CERTIFIKIMIN E PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË SHRSF-SË

17. Për t'u pajisur me certifikatën e punonjësit të shërbimit, kandidati, i shoqëruar nga drejtuesi teknik i shoqërisë, duhet të paraqesë në DPQ, në territorin e së cilës është banor i përhershëm kandidati, si dhe ushtron aktivitetin shoqëria e ruajtjes dhe sigurisë fizike, këto dokumente:

a) Autodeklarim "Për punonjës shërbimi", sipas formularit model 3, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi.

b) Dokument identifikimi i njohur nga legjislacioni në fuqi.

c) Vetëdeklarim (për verifikimin e gjendjes gjyqësore) sipas formularit model 5, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi.

d) Dokument shkollor që ka mbaruar arsimin e detyrueshëm.

e) Raport nga komisioni mjeko-ligjor, që është i aftë nga ana e shëndetit fizik e mendor.

f) Vërtetim nga dega e mobilizimit të ushtrisë se e ka kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak.

g) Fotografi të kandidatit, 4 copë, me përmasa 4 x 6 cm.

h) Vërtetimi i arsyetuar nga drejtuesi teknik i SHRSF-së "Për kryerjen me sukses të kursit të trajnimit nga kandidati, jo më pak se 15 ditë".

18. Për pranimin, verifikimin e shqyrtimit të kërkesave për certifikimin e punonjësve të shërbimit të SHRSF-së, në DPQ ndiqen e zbatohen procedurat e përcaktuara në germat "a", "b", "c" dhe "d" të pikës 5 të këtij udhëzimi. Sektori përkatës në drejtorinë e policisë së qarkut kërkon kryerjen edhe të këtyre procedurave:

a) përgatitjen e dokumentit të vërtetimit të besueshmërisë, nga komisariati i policisë, duke pasqyruar adresën e vendbanimit të kandidatit dhe arsyet e kërkesës;

b) përgatitjen dhe kryerjen e procedurave të testimit profesional për kandidatin nga komisioni përkatës i ngritur pranë DPQ-së.

19. Drejtoria e policisë qarkut dhe komisariati i policisë që ka në juridiksion vendbanimin e përhershëm të kandidatit, brenda 20 ditëve nga dita e marrjes së kërkesës, përgatit dhe dërgon vërtetimin e besueshmërisë sipas procedurave dhe rregullave të përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.

20. Komisioni i testimit të njohurive profesionale në DPQ, jo më pak se një herë në muaj, mblidhet dhe zhvillon testimin vlerësues sipas rregullave të përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, duke vlerësuar nëse kandidati është ose jo i aftë nga ana profesionale për kryerjen e detyrës së punonjësit të shërbimit të SHRSF-së.

21. Në përfundim të procesit, sektori që mbulon veprimtarinë e SHRSF-ve, i kalon për shqyrtim KSHKC-së, në DPQ, i cili mblidhet në intervalin e datave 20-25 të çdo muaji, materialin shkresor të grumbulluar, së bashku me dokumentet e dorëzuara nga kandidati për punonjës shërbimi, me një relacion përmbledhës.

22. Komisioni (KSHKC) vlerëson besueshmërinë dhe përshtatshmërinë e kandidatit, duke u bazuar në dokumentet, rezultatet e testimit profesional, moshën etj. Në përfundim të procesit, komisioni jep mendimin paraprak, duke përgatitur propozimin në formë relacioni për drejtorin e policisë së qarkut. Certifikata sipas modelit tip 8, bashkëlidhur këtij udhëzimi, i paraqitet për miratim drejtorit të policisë së qarkut.

23. Certifikata e punonjësit të shërbimit të shoqërisë së ruajtjes dhe sigurisë fizike, përgatitet në dy kopje, një prej të cilave i jepet punonjësit të shërbimit dhe tjetra administrohet, së bashku me dokumentet që kanë mundësuar dhënien e saj në kartotekën (sekretarinë) e drejtorisë së policisë së qarkut. Në rastet e mosmiratimit të dhënies së certifikatës së kërkuar brenda 6 ditëve nga marrja e vendimit, bëhet njoftimi me shkrim i aplikantit.

24. Transferimi i punonjësit të shërbimit nga njëra shoqëri te tjetra lejohet të bëhet me kërkesë me shkrim të drejtuesit teknik të SHRSF-së, që e merr atë në punë dhe të punonjësit të shërbimit, të drejtuara DPQ. Mbi bazën e dy kërkesave, specialisti i drejtimit për SHRSF-të, kur nuk ka pengesë ligjore, me miratim të shefit të sektorit, kryen ndryshimet për transferimin në regjistrat dhe evidencat e policisë, duke përgatitur e dërguar brenda 5 ditëve njoftimin zyrtar me shkrim për miratimin ose jo të transferimit të punonjësit të shërbimit.

25. E njëjta procedurë si në pikën 24 ndiqet edhe në rastin kur punonjësi i shërbimit ka mbetur pa punë për shkak të shkurtimeve apo të mungesës së tregut të punës, për një periudhë kohore më pak se një vit. Në rast se punonjësi ka një periudhë më shumë se një vit pa punë, atëherë kryen procedurat vetëm për vlerësimin e kriterit të besueshmërisë, duke bërë veprimet nëpërmjet KSHKC-së, i cili shprehet për lejimin e rifillimit të punës, duke dërguar njoftimin si në rastin e transferimit, apo për heqjen e certifikatës së punonjësit të shërbimit.

V
DOKUMENTET QË ADMINISTROHEN E RUHEN NGA STRUKTURAT E POLICISË SË SHTETIT

26. Me qëllim disiplinimin dhe kontrollin administrativ të veprimtarisë së SHRSF-ve, në strukturat e Policisë së Shtetit në qendër dhe pranë DPQ-ve, të krijohet sistemi i kartotekës dhe *data baze* në rrjetin informatik të policisë, me të dhëna për të gjitha certifikimet, autorizimet, lejet, armatimin, masat administrative e gjithçka tjetër që lidhet me kompetencat ligjore të policisë në fushën e veprimtarisë së SHRSF-ve.

27. Për subjektet e veprimtarisë së shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në kartotekën e sektorit përkatës në DPPSH krijohen, ruhen dhe administrohen këto dokumente:

a) Regjistri me të dhënat kryesore për titullarët dhe drejtuesit teknikë.

b) Regjistri për subjektet në fushën e SHRSF-së.

c) Fashikulli personal i drejtuesit teknik, në të cilin vendosen e ruhen të gjitha materialet shkresore që kanë shërbyer për certifikim, së bashku me kopjen e certifikatës.

d) Kartela personale për drejtuesin teknik.

e) Fashikulli personal i titullarit të subjektit, në të cilin vendosen e ruhen të gjitha materialet shkresore që kanë shërbyer për certifikim.

f) Dosja e subjektit të SHRSF-së, në të cilën vendosen e ruhen të gjitha materialet shkresore që kanë shërbyer për miratimin e licencës apo të rilicencimit. Pjesë e kësaj dosjeje janë edhe dy fashikujt sipas shkronjave "c" dhe "d" të kësaj pike, për personat që janë në marrëdhënie pune në këtë shoqëri.

28. Për punonjësin e shërbimit të SHRSF-së, në DPQ, krijohet dhe ruhen këto dokumente:

a) Fashikulli për punonjësin e shërbimit, së bashku me një kopje të certifikatës.

b) Regjistri i punonjësve të shërbimit të certifikuar.

c) Kartela personale e punonjësit të shërbimit.

Përmbajtja, ruajtja, mënyra e plotësimit dhe e administrimit të dokumenteve të parashikuara në këtë pikë dhe në pikën 27, rregullohen me akt të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

29. Me qëllim njohjen dhe kontrollin e aktivitetit të SHRSF-ve me aktivitet në territorin e DPQ-së, specialisti përgjegjës, për secilën shoqëri, çel e ruan dosjen e aktivitetit të tyre, në të cilën vendosen e administrohen këto dokumente:

a) Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike (fotokopje), së bashku me fotokopjet e certifikatave të drejtuesit teknik dhe të titullarit të subjektit.

b) Lista emërore e punonjësve të shërbimit, që ka në marrëdhënie pune.

c) Aktmarrëveshjet e përbashkëta (të nënshkruara midis drejtuesit teknik dhe përfaqësuesit të palës që merret në ruajtje), që lidhen në zbatim dhe zbërthim të kontratës fillestare, kjo sipas nenit 6 të ligjit nr.8770 datë 19.4.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike".

d) Lista e armëve të krahut dhe të armëve të brezit, në të cilën të pasqyrohen: numri dhe lloji i armës, emri i punonjësit që e mban atë, objekti ku arma përdoret për shërbim.

e) Licenca për mjetet e ndërlidhjes për shoqëritë që kanë sallë operative.

f) Plani i dislokimit të shërbimit për secilin objekt që ka marrë në ruajtje shoqëria, së bashku me skicën ku pasqyrohen dhe vendrojat dhe oraret e shërbimit. Si rregull përpilohet në fillim të çdo viti dhe sa herë që ka ndryshime të numrit të objekteve të marra apo hequra nga ruajtja.

g) Kopje e planeve të masave për raste emergjencash, për objektet e rëndësishme ku ruhen vlera të mëdha materiale e monetare, apo që frekuentohen nga një numër i madh personash.

h) Evidenca e masave administrative të dhëna ndaj SHRSF-së dhe punonjësve të shërbimit të saj.

i) Informacione të dhëna nga drejtuesi teknik, si dhe çdo korrespondencë tjetër që lidhet me procesin e organizimit dhe mbarëvajtjes së shërbimeve të shoqërisë me strukturat e Policisë së Shtetit.

j) Stema e shoqërisë.

k) Numri i automjeteve të blinduara me targa dhe autorizimet e përdorimit të tyre.

l) Lista e inventarit të pajisjeve dhe armëve speciale, si dhe procesverbalet e konsumimit, shpenzimit apo asgjësimit të tyre.

VI
KONTROLLI I VEPRIMTARISË SË SHRSF-VE

30. Të gjithë punonjësit e policisë, pavarësisht nga niveli e funksioni që kryejnë, kanë të drejtë që gjatë përmbushjes së rregullt të detyrës, të evidentojnë çdo informacion e shkelje, që lidhet me veprimtarinë e paligjshme të SHRSF-ve dhe të personelit të tyre. Në varësi të llojit të shkeljes së konstatuar, nga drejtoria e policisë së qarkut, nëpërmjet strukturave përkatëse, brenda 30 ditëve, bëhet vlerësimi i rastit, duke përcaktuar e marrë masat konkrete.

31. Sektori i rendit dhe sigurisë publike të DPQ-së, në varësi të territorit ku ushtron aktivitetin shoqëria e ruajtjes dhe sigurisë fizike, me qëllim njohje dhe kontrolli, i dërgon njoftim komisariatit të policisë përkatëse për adresën e objektit, listën emërore të punonjësve të shërbimit dhe të armatimit që kanë në përdorim. Këto të dhëna kontrollohen dhe pasqyrohen në evidencat e specialistëve dhe ndihmësspecialistëve të policisë që mbulojnë territorin përkatës.

32. Kontrolli i shërbimeve dhe veprimtarisë së SHRSF-ve nga drejtoria e policisë së qarkut, kryhet i planifikuar ose sa herë që lind nevoja për të verifikuar një informacion, ankesë apo për çështje sigurie.

33. Drejtoritë e policisë në qarqe, në muajt janar dhe korrik të çdo viti, hartojnë plane të veçanta kontrolli për periudhën 6-mujore, për të gjitha shërbimet e SHRSF-ve dhe të aktivitetit të raportuar për territorin e tyre. Ky plan kontrolli të ndiqet e zbatohet nga sektori përkatës i DPQ-së, në bashkëpunim me strukturat e tjera brenda drejtorisë dhe me komisariatet e policisë.

34. Për çdo kontroll të ushtruar ndaj SHRSF-ve përpilohet akti i kontrollit, i firmosur nga të pranishmit; një kopje i lihet drejtuesit teknik dhe një kopje administrohet në dosjen e SHRSF-së. Kur konstatohen shkelje, përpilohet procesverbali i konstatimit dhe më pas procedohet sipas rastit, për masë administrative ose penale.

35. Në të gjitha rastet e informacioneve policore apo të konstatimeve nga kontrollet e ushtruara, që bëjnë fjalë për humbjen e mundshme të besueshmërisë apo të përshtatshmërisë nga ana e SHRSF-së apo personeli i tyre, menjëherë të kryhen veprimet e nevojshme verifikuese e sqaruese dhe rasti të paraqitet për shqyrtim në komision, i cili mund të vendosë, sipas rastit, heqjen e certifikatës deri në heqjen e licencës për subjektin, duke njoftuar sipas rastit QKL-në.

36. Komisioni i shqyrtimit të kërkesave për certifikim, në DPQ dhe në DPPSH, është njëkohësisht struktura që do të merret me shqyrtimin e vlerësimin e shkeljeve administrative të ligjit nr.8770, datë 19.4.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike", të ndryshuar.

37. Drejtoritë e policisë së qarqeve, nëpërmjet sektorit përkatës, organizojnë bashkëpunimin dhe shkëmbejnë informacion me strukturat e tjera lokale shtetërore, si zyrat e tatimeve, zyrat e punës, sigurimet shoqërore, prokurorinë etj., me qëllim shtimin e masave të kontrollit dhe verifikimit të veprimtarisë së SHRSF-ve. Këtyre strukturave një herë në gjashtë muaj u dërgohen të dhënat me listat emërore të punonjësve të shërbimit për secilën shoqëri dhe për aktivitetin e tyre.

VII
DETYRIMET E SHRSF-VE

38. Subjektet e licencuara në fushën e veprimtarisë së ruajtjes dhe sigurisë fizike dhe personeli i shërbimit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, duhet të respektojnë e përmbushin këto detyrime:

a) Të mos përdorë aktivitetin për të cilin është licencuar për të kryer, lehtësuar apo fshehur një veprimtari të kundërligjshme.

b) Gjatë ushtrimit të veprimtarisë të mos kufizojë apo cenojë liritë e të drejtat e njeriut apo hapësirat dhe territoret publike.

c) Të fillojë veprimtarinë brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e licencës.

d) Të mos u japë armë dhe municione, mjete të blinduara shtetasve të cilët nuk janë të pajisur me leje përkatëse nga Policia e Shtetit.

e) Të raportojë në strukturat e policisë për veprimtarinë e ruajtjes dhe sigurisë fizike që ushtron, në çdo 3 muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës.

f) Të mbajë regjistra të protokolluar me të dhëna të plota për veprimtarinë që kryen, numrin e objekteve dhe punonjësve, armët dhe municionet, mjetet e shërbimit të miratuara nga Policia e Shtetit e të dhëna të tjera, sipas legjislacionit në fuqi. Këto akte me regjistrimet përkatëse duhet të jenë në çdo moment të vlefshme për inspektim nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit.

g) Të marrë masat e nevojshme për sigurimin teknik në lidhje me armët dhe municionet, mjetet e shërbimit, sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim parandalimin e aksidenteve, ngjarjeve të rënda për jetën, pronën, sigurinë etj.

h) Të paguajë detyrimet financiare ndaj shtetit në afatin e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

i) Në çdo rast punësimi të personelit të shërbimit, duhet që më parë të ketë siguruar certifikimin e tyre nga organi përgjegjës.

j) Të përmbushë detyrat e lëna me shkrim nga organet përgjegjëse brenda afateve të caktuara.

k) Subjekti dhe personeli përkatës, në rastet kur do të vazhdojnë aktivitetin, duhet të aplikojnë për ripërtëritjen e licencës përkatëse 3 muaj përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së tyre.

l) Subjektet duhet të ushtrojnë aktivitetin e tyre vetëm për llojin e veprimtarisë specifike për të cilën janë të licencuara.

ll) Të gjitha kontratat që një SHRSF lidh me subjekte të ndryshme për veprimtarinë e ruajtjes dhe sigurisë fizike, duhet të nënshkruhen edhe nga drejtuesi teknik, si personi përgjegjës për zbatimin e detyrimeve të kontratës, në përputhje me rregullat e sigurisë.

m) Drejtuesit e mjeteve të blinduara të jenë të certifikuar si punonjës shërbimi, si dhe të jenë të pajisur me autorizimin përkatës nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

n) Drejtuesi teknik i subjektit që ushtron veprimtarinë e ruajtjes dhe sigurisë teknike është në funksion me kohë të plotë pune.

o) Me largimin e drejtuesit teknik nga shoqëria, menjëherë të njoftohet struktura përkatëse e policisë ku ka aktivitet shoqëria dhe brenda afatit ligjor të aplikojë për drejtuesin e ri teknik.

VIII
DISPOZITA TË FUNDIT

39. Ngarkohen të gjitha strukturat dhe personeli i Policisë së Shtetit, si dhe personeli i shoqërive të ruajtjes e sigurisë fizike me njohjen e zbatimin e këtij udhëzimi.

40. Me kontrollin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këtë udhëzim, ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

41. Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr.1487 datë 21.6.2001 “Për procedurat e dhënies dhe heqjes së licencave dhe lejeve për shoqëritë e ruajtjes dhe sigurisë fizike”, të ndryshuar, si dhe udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr.1488, datë 21.6.2001 “Për kontrollin e kryerjes së shërbimit nga shoqëritë e ruajtjes dhe të sigurisë fizike”, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Lulzim Basha

Model 1

AUTODEKLARIM

Për certifikim "titullar subjekti" që licencohet për veprimtarinë e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike

Drejtuar: Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Tiranë, më datë ___ . ___. 200_

PJESA E PARË

Unë i nënshkruari ……..... i biri/bija..... dhe i .....

(emër, mbiemër)

i datëlindjes ..... lindur në ..... dhe banues në (adresa e plotë) ……..

Adresën e selisë .....……..... qarku .....

Tel ……..... .. mobil (cel.) ……..…….. e-mail .....

Dokumenti identifikues; pasaportë nr, ... kartë identiteti nr. ....

Arsimi i kryer ..... dokumenti. nr.....

datë..... institucioni arsimor .....

KËRKOJ

të pajisem me certifikatën për "titullar subjekti", për veprimtari në fushën e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike. Deklaroj se:

Veprimtarinë time do ta kryej: Vetëm ☐ Me ortak ☐ I punësuar ☐
Nëse nuk do ta kryeni vetëm, sipas rastit jepni shpjegime për gjenealitetet e ortakut apo ortakëve (emër, atësi, mbiemër), adresën e vendbanimit, profesioni, etj. apo të punëdhënësit.
.....
.....

1. Përmbledhje e veprimtarisë jetësore:
Profesioni bazë .....
Keni marrëdhënie pune aktualisht? Po ☐ ose Jo,☐
Nëse po, institucioni, ndërmarrja apo firma .....

Momente kryesore të veprimtarisë suaj pas përfundimit të arsimit detyrueshëm në vitin 19_
- Nga periudha: 19_ _ deri në 19_ _ .....
- Nga periudha: 19_ _ deri në 19_ _ .....
- Nga periudha: 19_ _ deri në 19_ _ .....
- Nga periudha: 19_ _ deri në 19_ _ .....

.....
.....
.....
.....
.....
.....

- Keni licencë apo certifikatë të mëparshme të lëshuar nga Policia e Shtetit Po ☐ Jo ☐
- Nëse po specifikoni llojin, periudhën dhe organin e policisë që e ka lëshuar .....
.....

a) A keni ju dhe familja juaj konflikt me persona të tjerë? Po ☐ Jo ☐
b) A jeni ju dhe familja juaj të përfshirë në fenomenin e hakmarrjes apo të gjakmarrjes? Po ☐ Jo ☐

Nëse dëshironi bëni komente e sqarime rreth pyetjes "a" dhe "b", ...
.....
.....

c) A keni varësi nga alkooli? Po ☐ Jo ☐
d) Jeni përdorues droge, apo të substancave tjera dehëse? Po ☐ Jo ☐
e) Në përbërjen tuaj familjare keni persona të sëmurë nga ana e shëndetit mendor? Po ☐ Jo ☐

2. Argumentoni se keni njohuri të mjaftueshme dhe se jeni në gjendje të administroni dhe menaxhoni veprimtarinë e SHRSF-së, për të cilat kërkoni të pajiseni me certifikatë e licencë, sipas kërkesave ligjore e nënligjore në këtë fushë.

.....
.....
.....
.....

3. Argumentoni se keni njohuri të mjaftueshme të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fushën e përdorimit, ruajtjes e mirëmbajtjes së armëve te zjarrit, si dhe do të zbatoni të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

.....
.....
.....

4. Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që :

a) njoh kuadrin ligjor dhe nënligjor në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin.
b) do të zbatoj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

PJESA E DYTË

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë:

a**)** Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: ☐ i/e padënuar. ☐ i/e dënuar

b) Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam:

- në ndjekje penale nga organi i prokurorisë; Po ☐ Jo ☐
- në ndjekje penale nga sistemi gjyqësor ; Po ☐ Jo ☐

c) Detyrim financiar ndaj zyrës përmbarimit dhe asnjë ndonjë institucioni tjetër shtetëror: Po ☐ Jo ☐

d) Jam i regjistruar për aktivitetin që po aplikoj, në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të bizneseve me nr. ..... datë ..... në _____

f) Jam i regjistruar në organet tatimore me nr. NIPT-i.....

g) Keni licencë të mëparshme? Po ☐ Jo ☐

Nëse po, specifikoni fushën e veprimtarisë.....

Keni kryer regjistrime të tjera në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ? ☐ Po ☐ Jo

Nëse po, specifiko llojin e ndryshimit…….....
…….....

PJESA E TRETË

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1. Pjesë e autodeklarimit tim janë edhe të gjitha dokumentet e tjera teknike, sipas udhëzimit të Ministrit Brendshëm nr. _____, datë __.__.2009 "Për procedurat e certifikimit, lejimit dhe kontrollit të veprimtarisë së shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike".
2. Jam në dijeni se kur drejtuesi teknik largohet nga kjo veprimtari duhen njoftuar menjëherë strukturat përkatëse të policisë dhe duhet paraqitur kërkesa për zëvendësimin e tij.

DEKLARUESI	**MARRËSI I AUTODEKLARIMIT**
_____	_____
(Emër, mbiemër /firma)	(Grada, emër, mbiemër / firma)

Shënim.

1. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi ligjore dhe sjell pasojë kur vërtetohen se dokumentet janë të falsifikuara.
2. Deklarimi i rremë sjell pasojë kur të dhënat janë në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme për të cilat keni aplikuar në këtë autodeklarim.

Rregulli për plotësimin e formularit

Formulari të plotësohet duke përdorur një mjet shkrimi që nuk fshihet dhe për opsionet e vendosura me përzgjedhje në formular, të realizohet duke bërë shenjë të dukshme mbi kuadratin përkatës.

AUTORIZIM

Unë i nënshkruari ..... i biri/bija..... dhe i ..... deklaroj se te dhënat e paraqitura në ketë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga strukturat përkatëse të Policisë se Shtetit.

_____	_____
Nënshkrimi i deklaruesit	Data e nënshkrimit

Model 2

AUTODEKLARIM

Për certifikim "drejtues teknik" për veprimtarinë e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike

Drejtuar: Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Tiranë, më datë ___ . ___. 200_

PJESA E PARË

Unë i nënshkruari ……..... i biri/bija ..... dhe i .....
(emër, mbiemër)

i datëlindjes ..... lindur në ..... dhe banues në (adresa e plotë) .....

Adresën e selisë .....……..... qarku .....

Tel ……..... .. mobil (cel.) ……..…….... e-mail .....

Dokumenti identifikues; pasaportë nr, ... kartë identiteti nr. ....

Arsimi i kryer ..... dokumenti. nr.....

datë..... institucioni arsimor .....

KËRKOJ

të pajisem me certifikatën "drejtues teknik" për veprimtari të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike.

1. Përmbledhje e veprimtarisë jetësore:

Profesioni bazë: .....

Keni marrëdhënie pune aktualisht? Po ☐ ose Jo ☐

Nëse po, institucioni, ndërmarrja apo firma .....

Momente kryesore të veprimtarisë suaj pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm në vitin 19_ _

- Nga periudha: 19_ _ deri në 19_ _ .....
- Nga periudha: 19_ _ deri në 19_ _ .....
- Nga periudha: 19_ _ deri në 19_ _ .....
- Nga periudha: 19_ _ deri në 19_ _ .....

.....
.....
.....
.....
.....
.....

Keni licencë apo certifikatë të mëparshme të lëshuar nga Policia e Shtetit? Po ☐ Jo ☐

Nëse po, specifikoni llojin, periudhën dhe organin e policisë që e ka lëshuar .....
.....

a) A keni ju dhe familja juaj konflikt me persona të tjerë? Po ☐ Jo ☐

b) A jeni ju dhe familja juaj të përfshirë në fenomenin e hakmarrjes apo të gjakmarrjes? Po ☐ Jo ☐

Nëse dëshironi komente e sqarime rreth pyetjes "a" dhe "b".....
.....
.....
.....

c) A keni vartësi nga alkooli? Po ☐ Jo ☐

d) Jeni përdorues droge, apo të substancave tjera dehëse? Po ☐ Jo ☐

e) Në përbërjen tuaj familjare keni persona të sëmurë nga ana e shëndetit mendor?

Po ☐ Jo ☐

2. Argumentoni se keni njohuri të mjaftueshme dhe se jeni në gjendje të organizoni, drejtoni dhe menaxhoni shërbimet e ruajtjes dhe sigurisë fizike, të organizuara në formën e SHRSF-së, për të cilat kërkoni te pajiseni me certifikatë.

.....
.....
.....
.....

3. Argumentoni se keni njohuri të mjaftueshme të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fushën e përdorimit, ruajtjes e mirëmbajtjes së armëve të zjarrit, si dhe do të zbatoni të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

.....
.....
.....

4. Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

a) njoh kuadrin ligjor dhe nënligjor në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin;

b) do të zbatoj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

PJESA E DYTË

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë:

a**)** Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: ☐ i/e padënuar. ☐ i/e dënuar

b) Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam:

- në ndjekje penale nga organi i prokurorisë; Po ☐ Jo ☐
- në ndjekje penale nga sistemi gjyqësor; Po ☐ Jo ☐

c) Detyrim financiar ndaj zyrës së përmbarimit dhe asnjë ndonjë institucioni tjetër shtetëror.

Po ☐ Jo ☐

g) Keni licencë të mëparshme? Po☐ Jo ☐

Nëse po, specifikoni fushën e veprimtarisë.....

Keni kryer regjistrime të tjera në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit? ☐ Po ☐ Jo

Nëse po, specifiko llojin e ndryshimit…….....
…….....

PJESA E TRETË

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1. Jam në dijeni se funksioni i drejtuesit teknik është drejtuesi më i lartë teknik i shoqërisë dhe përgjegjësi ligjore për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e shërbimit të SHRSF-së.
2. Pjesë e autodeklarimit tim janë edhe të gjitha dokumentet e tjera teknike, sipas udhëzimit të Ministrit Brendshëm nr._____, datë __.__.2009 "Për procedurat e certifikimit, lejimit dhe kontrollit të veprimtarisë së shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike".
3. Jam në dijeni se kur drejtuesi teknik largohet nga kjo veprimtari, duhen njoftuar menjëherë strukturat përkatëse të policisë.

DEKLARUESI **MARRËSI I AUTODEKLARIMIT**

_____ _____

(Emër, mbiemër /firma) (Grada, emër, mbiemër /firma)

Shënim.

1. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi ligjore dhe sjell pasojë kur vërtetohen se dokumentet janë të falsifikuara.
2. Deklarimi i rremë sjell pasojë kur të dhënat janë në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme, për të cilat keni aplikuar në këtë autodeklarim.

Rregulli për plotësimin e formularit

Formulari të plotësohet duke përdorur një mjet shkrimi që nuk fshihet dhe për opsionet e vendosura me përzgjedhje në formular, të realizohet duke bërë shenjë të dukshme mbi kuadratin përkatës.

AUTORIZIM

Unë i nënshkruari ..... i biri/bija ..... dhe i ..... deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit.

_____ _____

Nënshkrimi i deklaruesit Data e nënshkrimit

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr.8517, datë 22.7.1999 " Për mbrojtjen e të dhënave personale".

AUTODEKLARIM

Për certifikimin "punonjës shërbimi" në veprimtarinë e ruajtjes dhe sigurisë fizike

Drejtuar: Drejtorisë së Policisë së Qarkut _____ sot më datë .___.___. 200

PJESA E PARË

Unë i nënshkruari ……..... i biri/bija ..... dhe i .....
(emër, mbiemër)

i datëlindjes ..... lindur më ..... dhe banues në (adresa e plotë) ....

Adresën e selisë .....……..... qarku .....

tel ……..... .. mobil (cel.) ……..…….... e-mail .....

Dokumenti identifikues; pasaportë nr, ... kartë identiteti nr. ....

Arsimi i kryer ..... dokumenti. nr.....

datë..... institucioni arsimor .....

KËRKOJ

të pajisem me certifikatën si punonjës shërbimi për veprimtarinë e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, pranë shoqërisë së ruajtjes dhe sigurisë fizike .... , me drejtues teknik zotin .....

1. Përmbledhje e veprimtarisë jetësore :

Profesioni bazë: .....

Keni marrëdhënie pune aktualisht? Po ☐ ose Jo☐

Nëse po, institucioni, ndërmarrja apo firma .....

Momente kryesore të veprimtarisë suaj pas përfundimit të arsimit detyrueshëm në vitin 19_ _

- Nga periudha: 19_ _ deri në 19_ _ .....
- Nga periudha: 19_ _ deri në 19_ _ .....
- Nga periudha: 19_ _ deri në 19_ _ .....
- Nga periudha: 19_ _ deri në 19_ _ .....

.....
.....
.....
.....
.....
.....

Keni licencë apo certifikatë të mëparshme të lëshuar nga Policia e Shtetit? Po ☐ Jo ☐

Nëse po, specifikoni llojin, periudhën dhe organin e policisë që e ka lëshuar .....
.....
Kam si profesion bazë .....

a) A keni ju dhe familja juaj konflikt me persona të tjerë? Po ☐ Jo ☐
b) A jeni ju dhe familja juaj të përfshirë në fenomenin e hakmarrjes apo të gjakmarrjes? Po ☐ Jo ☐
Nëse dëshironi, komente e sqarime rreth pyetjes "a" dhe "b". .....
.....
.....
.....

c) A keni varësi nga alkooli? Po ☐ Jo ☐
d) Jeni përdorues droge, apo të substancave të tjera dehëse? Po ☐ Jo ☐
e) Në përbërjen tuaj familjare keni persona të sëmurë nga ana e shëndetit mendor?
Po ☐ Jo ☐

2. Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që :
a) njoh kuadrin ligjor dhe nënligjor në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin;
b) do të zbatoj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

Keni qenë më parë i pajisur me leje të punonjësit të shërbimit ? Po☐ Jo ☐

Nëse po, specifikoni SHRSF-në ku keni punuar dhe arsyen e largimit .....
.....
.....
Deklaroj se kam vënë në dijeni drejtuesin teknik për kërkesën për largim Po ☐ Jo ☐

PJESA E DYTË

1. Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë:

a) Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: ☐ i/e padënuar. ☐ i/e dënuar

b) Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam:
- në ndjekje penale nga organi i prokurorisë; Po ☐ Jo ☐
- në ndjekje penale nga sistemi gjyqësor ; Po ☐ Jo ☐

c) Detyrim financiar ndaj zyrës së përmbarimit dhe asnjë ndonjë institucioni tjetër shtetëror.
Po ☐ Jo ☐
Nëse po, shëno emrin .....

PJESA E TRETË

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1. Pjesë e autodeklarimit tim janë edhe të gjitha dokumentet e tjera teknike, sipas udhëzimit të Ministrit Brendshëm nr._____, datë __.__.2009 "Për procedurat e certifikimit, lejimit dhe kontrollit të veprimtarisë së shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike".
2. Jam në dijeni se kur punonjësi i shërbimit largohet nga kjo veprimtari, duhet të njoftojë 5 ditë përpara drejtuesin teknik të shoqërisë.

DEKLARUESI	DREJTUESI TEKNIK	MARRËSI I AUTODEKLARIMIT
_____	_____	_____
Emër, mbiemër /firma	Emër, mbiemër/firma	Grada, emër, mbiemër/firma

Shënim.

1. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi dhe sjell ndëshkim ligjor kur vërtetohen se dokumentet janë të falsifikuara.
2. Deklarimi i rremë sjell pasojë kur të dhënat janë në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme, për të cilat keni aplikuar në këtë autodeklarim.

Rregulli për plotësimin e formularit

Formulari të plotësohet duke përdorur një mjet shkrimi që nuk fshihet dhe për opsionet e vendosura me përzgjedhje në formular të realizohet duke bërë shenjë të dukshme mbi kuadratin përkatës.

AUTORIZIM

Unë i nënshkruari ..... i biri/e bija ..... dhe i ..... deklaroj se te dhënat e paraqitura në ketë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit.

_____ _____

Nënshkrimi i deklaruesit Data e nënshkrimit

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr.8517, datë 22.07.1999 " Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Model 4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Drejtoria e Policisë së Qarkut

Nr._____Prot. _____ , më.___.__. 200_

VËRTETIM
Për pranimin e dokumenteve

Me anën e të cilit vërtetojmë se, bazuar në ligjin nr.8770, datë 19.4.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike", si dhe udhëzimin e Ministrit të Brendshëm "Për procedurat e certifikimit, lejimit dhe kontrollit të veprimtarisë së shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike", me nr. _____, datë __.__.2009

Z./znj …… në datën ……...……...
ka dorëzuar në _____ dokumentet e mëposhtme:

1. _____
2._____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____
_____

Mbyllet me numër rendor _____

Dorëzuesi i dokumenteve Punonjësi i policisë

(_____) (_____)

Model 5

VETËDEKLARIM
(Për verifikimin e gjendjes gjyqësore)

Mbiemër, emër		
Atësia /amësia		
Datëlindja		
Vendlindja		
Dokumenti i identifikimit (Kopje bashkëngjitur deklarimit)		

Të dhënat e vetëdeklarimit:
Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: ☐i/e padënuar. ☐ i/e dënuar

DEKLARUESI **MARRËSI I VETËDEKLARIMIT**

_____ _____
Emër, mbiemër/firma Grada, emër, mbiemër /firma/

Autorizim

Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga Policia e Shtetit.

_____ _____
Nënshkrimi i deklaruesit Data e nënshkrimit

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr.8517, datë 22.7.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".
Deklarimi e rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

Model _____

REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA PËRGJITHSHME E POLICISË

Nr._____ . Tirane me ___.___. 2009

ÇERTIFIKATE

Për Titullar Subjekti

(ne fushën e veprimtarisë se shërbimit te ruajtjes e sigurisë fizike)

Zoti /Znj _____

(Emri, Atësi, , Mbiemri)

Vitlindja _____ Vendlindja, _____ Vendbanimi _____

Gjendet i përshtatshëm dhe ka besueshmërinë e kërkuar për te ushtruar aktivitet si titullar subjekti ne fushën e veprimtarisë se shërbimit te ruajtjes dhe sigurisë fizike.

Kjo çertifikate është e vlefshme për tu paraqitur pranë Qendrës Kombëtare te Licensimit për marrjen e licensës se subjektit për ushtrimin e veprimtarisë se "shërbimit te ruajtjes dhe sigurisë fizike".

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISE

_____

Shënim: Kjo çertifikate mund te behet e pavlefshme nga strukturat përkatëse te Policisë Shtetit për shkeljet e kryera nga poseduesi i saj.

Model _____

REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA PËRGJITHSHME E POLICISË

Nr.____ . Tirane me ___.___. 2009

ÇERTIFIKATE

Për Drejtues Teknik Subjekti

(ne fushën e veprimtarisë se shërbimit te ruajtjes e sigurisë fizike)

Zoti /Znj _____

(Emri, Atësi, , Mbiemri)

Vitlindja _____ **Vendlindja,** _____ **Vendbanimi** _____

Gjendet i përshtatshëm nga ana profesionale dhe ka besueshmërinë e kërkuar për te ushtruar aktivitet si drejtues teknik ne fushën e veprimtarisë se shërbimit te ruajtjes dhe sigurisë fizike

Kjo çertifikate është e vlefshme për tu paraqitur pranë Qendrës Kombëtare te Liçensimit për te kryer veprimet përkatëse për regjistrim e liçensim të subjektit, për veprimtaritë ne fushën e shërbimit te ruajtjes dhe sigurisë fizike.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISE

_____

Shënim:
- Kjo çertifikate mund te behet e pavlefshme nga strukturat përkatëse te Policisë Shtetit për shkeljet e kryera nga poseduesi i saj..

Model tip 8

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Brendshme
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
Drejtoria e Policisë së Qarkut

ÇERTIFIKATE

Nr._____, datë ___.___. 2009

PËR
PUNONJËS SHËRBIMI
(Në fushën e veprimtarisë së shërbimit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Brendshme
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
Drejtoria e Policisë së Qarkut

ÇERTIFIKATE

Nr._____, datë ___.___. 2009

PËR
PUNONJËS SHËRBIMI
(Në fushën e veprimtarisë së shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike)

Drejtoria e Policisë së Qarkut _____,
në përfundim të procesit të verifikimit e të shqyrtimit të dokumenteve provuese,

VENDOSI :

Dhënien e certifikatës së punonjësit të shërbimit,



zotit, _____

(Emri, atësia, mbimeri)

Për lejimin e ushtrimit të profesionit të punonjësit të shërbimit të SHRSF-së.

KUJTESË
Detyrat kryesore të punonjësit të shërbimit gjatë veprimtarisë në SHRSF-ë:

1. Të respektojë e të mos kufizojnë apo cenojnë liritë e të drejtat e njeriut, apo hapësirat publike.
2. Të njoftojë menjëherë Policinë e Shtetit për veprat penale të ndodhura në objektin që ruan, si dhe të ruajë vendin e ngjarjes.
3. Të mos ua japë armën dhe municionet e shërbimit personave të tjerë
4. Të përdorë armën e zjarrit gjatë shërbimit në përputhje me ligjin përkatës.
5. T 'u japë të dhëna punonjësve të policisë sa herë që u kërkohet, për problemet e ruajtjes dhe sigurisë së objektit.
6. Të ndalojnë personat që përgatiten të kryejnë ose dyshohen se kanë kryer një vepër penale në objekt ose që kanë lidhje me këtë objekt.
7. Të kërkojë nga shtetasit zbatimin e rregullave të hyrje-daljeve në objekt të përcaktuara rregulloren e brendshme të objektit.

Drejtoria e Policisë së Qarkut _____,

në përfundim të procesit të verifikimit e të shqyrtimit të dokumenteve provuese,

VENDOSI:

Dhënien e certifikatës së punonjësit të Shërbimit,



Zotit, _____

(Emri, atësia, mbimeri)

Për lejimin e ushtrimit të profesionit të punonjësit të shërbimi të SHRSF-së.

KUJTESË

Detyrat kryesore të punonjësit të shërbimit gjatë veprimtarisë në SHRSF:

1. Të respektojë e të mos kufizojnë apo cenojnë liritë e të drejtat e njeriut, apo hapësirat publike.
2. Të njoftojë menjëherë Policinë e Shtetit për veprat penale të ndodhura në objektin që ruan, si dhe të ruajë vendin e ngjarjes.
3. Të mos u japë armën dhe municionet e shërbimit personave të tjerë.
4. Të përdorë armën e zjarrit gjatë shërbimit në përputhje me ligjin përkatës.
5. T'u japë të dhëna punonjësve të policisë sa herë që u kërkohet, për problemet e ruajtjes dhe sigurisë së objektit.
6. Të ndalojnë personat që përgatiten të kryejnë ose dyshohen se kanë kryer një vepër penale në objekt ose që kanë lidhje me këtë objekt.
7. Të kërkojë nga shtetasit zbatimin e rregullave të hyrje-daljeve në objekt të përcaktuara rregulloren e brendshme të objektit.

VENDIM
Nr.62, datë 15.9.2009

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PROCEDURAT E PARAQITJES DHE MIRATIMIT TË PLANIT TE INVESTIMEVE"

Mbështetur në nenet 9 dhe 24 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datë 15.9.2009, pasi shqyrtoi draftin rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike. (Bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

RREGULLORE
PËR PROCEDURAT E PARAQITJES DHE MIRATIMIT TË PLANIT TË INVESTIMEVE NGA TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe në përputhje me përgjegjësitë e ERE-s, të parashikuara nga nenet 8, pika 2, germa "c" dhe 22, pika 1, germa "c" të këtij ligji.

Neni 2
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje janë procedurat e paraqitjes dhe miratimit nga ERE të planit të investimeve të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike.

Neni 3
Qëllimi

Të përcaktojë mënyrën, formën dhe afatet e paraqitjes në ERE të planeve të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, si dhe kriteret e analizës së vlerësimit dhe miratimit të tyre nga ERE për të garantuar që planet e investimeve janë në përputhje me parimet e planifikimit me koston më të ulët.

Neni 4
Zbatimi

Kjo rregullore aplikohet për të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, të cilët kanë marrë licencë për një nga veprimtaritë e mëposhtme:

- Prodhimin e energjisë elektrike të destinuar për tregun e klientëve tariforë.
- Transmetimin e energjisë elektrike.
- Shpërndarjen e energjisë elektrike.

Neni 5
Përcaktime

Termat e përdorur në këtë rregullore do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1. "Ligj" do të thotë ligji nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" me të gjitha ndryshimet përkatëse.
2. "Bordi i Komisionerëve" do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.
3. "ERE" do të thotë Enti Rregullator i Energjisë.
4. "Aset" do të thotë aktivi afatgjatë material, që përdoret nga i licencuari dhe që i shërben realizimit të një prej aktiviteteve të prodhimit, shpërndarjes dhe transmetimit.
5. "Biznes" do të thotë veprimtari e licencuar nga ERE për shërbimet e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike.
6. "Investim" do të thotë tërësia e shpenzimeve, që kryhen nga një i licencuar për të shtuar vlerën e aseteve, që përdoret për kryerjen e veprimtarisë së licencuar.
7. "Plan i investimeve" do të thotë paraqitja e shpenzimeve kapitale sipas projekteve dhe/apo grupit të aseteve për një periudhë rregullimi.
8. "Person" do të thotë çdo person fizik ose juridik, qeveria ose çdo agjenci shtetërore, çdo autoritet lokal ose ente të tjera juridike të njohura nga ligji, përveç ERE-s.
9. "Licencë" do të thotë një autorizim i dhënë nga ERE, një personi për të operuar në sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat që kërkohen nga ligji nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe procedurave të licencimit të ERE-s.
10. "I licencuar" do të thotë një person, që mban një licencë të dhënë nga ERE. Për një nga veprimtaritë e përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje.
11. "Baza e rregulluar e aseteve" (RAB) do të thotë vlera e aseteve fikse, që zotërohen nga shoqëria dhe që përdoren për të kryer një nga veprimtaritë e përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje.
12. "Periudha rregullatore" do të thotë periudha gjatë së cilës tarifat e reja bëhen efektive dhe rregullohen/rishikohen sipas vendimit të marrë nga ERE.

KAPITULLI II
PLANET E INVESTIMEVE

Neni 6
Kërkesa të përgjithshme të hartimit të planeve të investimeve

Në hartimin e planeve të investimeve të licencuarit do të mbajnë parasysh parimet e mëposhtme:

- Planet e investimeve do të jenë në përputhje me kërkesat e ligjeve, rregulloreve, metodikave dhe të gjitha akteve nënligjore përkatëse, që rregullojnë studimet, projektimet dhe kryerjen e investimeve, përfshirë kërkesat për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, mjedisit dhe të sigurisë kombëtare. Planet e investimit duhet të jenë në harmoni me strategjitë kombëtare të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike.

- Planet e investimeve duhet të hartohen në mënyrë që të sigurojnë efektivitet të lartë, kosto të ulët, përfshirë marrjen parasysh të masave për menaxhimin e kërkesës për energji elektrike.

- Planet e investimeve duhet të marrin parasysh marrëdhëniet që i licencuari ka me pjesëmarrësit e tjerë të tregut për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjetik, si dhe plotësimin e kushteve të sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike të klientëve.

- Planet e investimeve do të jenë të hapura për publikun duke iu dhënë mundësinë të interesuarve, përfshirë dhe institucionet e ndryshme shtetërore, të japin komentet e tyre lidhur me këto plane.

Neni 7

Përgjegjësitë e të licencuarve

1. Çdo i licencuar në referencë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe në zbatim të licencës përkatëse të marrë nga ERE, është përgjegjës për hartimin e një plani investimi sipas periudhave të rregullimit dhe për çdo vit pasardhës për të plotësuar nevojat e klientëve me energji elektrike. Planet e investimeve do të shoqërohen me një relacion shpjegues, i cili do të përfshijë edhe paraqitjen tabelare dhe grafike të të dhënave referuese dhe një plan kohor zbatimi.

2. Të licencuarit në veprimtaritë e prodhimit publik, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike në fund të çdo periudhe rregullimi do të paraqesin planet e tyre të investimeve për periudhën rregullatore pasardhëse.

3. Të licencuarit do të paraqesin në ERE raportin vjetor të zbatimit të planeve të investimeve të vitit pasardhës duke treguar ecurinë e investimeve të planifikuara dhe duke siguruar shpjegim për çdo ndryshim në plan. Ky raportim do të bëhet jo më vonë se data 30 qershor e vitit në vijim.

Neni 8

Planet e investimeve për të licencuarit në veprimtaritë e prodhimit të energjisë elektrike

1. Planet e investimeve të të licencuarve në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike mbështeten në planifikimin e sasisë vjetore të energjisë elektrike për t'u prodhuar, i cili do të bëhet sipas dispozitave të pjesës së II-të, paragrafi 2.6, pika 2.6.1 të Kodit të Transmetimit.

2. Planet e investimeve për prodhuesit e energjisë elektrike mund të përmbajnë investime për:

- Centrale/njësi të reja prodhuese.
- Rehabilitim dhe modernizim të centraleve ekzistuese.
- Nxjerrje nga puna të njësive të vjetra.
- Rritje të kapaciteteve ekzistuese.

3. Çdo prodhues i licencuar, përveç të dhënave të detajuara të planifikimit teknik sipas shtojcës A, pjesa 2 të Kodit të Transemtimit, në planin e investimeve do të paraqesë edhe treguesit e mëposhtëm:

- Kapacitetin nominal të centralit gjenerues të ri/ apo të rehabilituar.
- Sasinë e energjisë elektrike, që pritet të prodhohet, nëse do të punonte me kapacitet të plotë.
- Faktorin e disponibilitetit, që merr në konsideratë kohën që centrali është i disponueshëm për të gjeneruar energji elektrike gjatë vitit.
- Periudhën e ndërtimit apo të rehabilitimit.
- Periudhën e pritshme të shlyerjes së investimit.
- Burimet e sigurimit të lëndës së parë për prodhimin e energjisë elektrike.
- Efiçencën energjetike, e cila merr në konsideratë llojin e teknologjisë, pajisjet, makineritë dhe lëndën djegëse.

Neni 9

Planet e investimeve për të licencuarit në veprimtarinë e transmetimit të energjisë elektrike

1. Planet e investimeve për të licencuarin në transmetimin e energjisë elektrike duhet të përmbajnë investime që synojnë:

- Përmirësimin dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë së tij dhe sigurisë së furnizimit të vendit me energji elektrike.
- Reduktimin e humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit.
- Rritjen e mundësisë për shpërndarjen dhe kontrollin në distancë të flukseve të energjisë elektrike.

2.Në planifikimin e investimeve për të plotësuar synimet e mësipërme, i licencuari duhet të bazohet dhe të respektojë:

- Kriteret e planifikimit dhe të zhvillimit të sistemit të transmetimit të përcaktuara në Kodin e Transmetimit, si dhe procedurat e parashikuara për zhvillimin e sistemit të transmetimit sipas pjesës së 2-të të tij (Kodi i Transmetimit).
- Informacionet dhe të dhënat e siguruara nga operatorët e tregut dhe përdoruesit e sistemit të transmetimit.
- Kriteret e projektimit të elementeve kryesore të rrjetit të transmetimit (linja dhe nënstacione).
- Periudhën e ndërtimit apo të rehabilitimit të një objekti.

3. Në planin e investimeve të parashikuara, i licencuari duhet të pasqyrojë listën e projekteve që do të zbatojë.

4. Plani i investimeve shoqërohet me relacione argumentuese lidhur me:

a) Metodologjitë e ndjekura për parashikimin e kërkesës, ngarkesës dhe ngarkesës pik duke i paraqitur në mënyrë tabelare dhe grafike.

b) Ndikimet e investimit në përmirësimin e kapaciteteve transmetuese, përmirësimin e humbjeve teknike etj.

c) Kostot, burimet e financimit, periudhat e shlyerjes së investimeve etj.

Neni 10

Planet e investimeve për të licencuarit në veprimtarinë e shpërndarjes së energjisë elektrike

1. Planet e investimeve për të licencuarit në shpërndarjen e energjisë elektrike duhet të përmbajnë investime që synojnë:

- Rritjen e shkallës së sigurisë së sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Zvogëlimin e humbjeve teknike dhe jo teknike në rrjetin e shpërndarjes.
- Mbajtjen e parametrave teknikë të furnizimit me energji elektrike të parashikuar në Kodin e Shpërndarjes.
- Plotësimin dhe modernizimin e sistemit të matjes së energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes.

2. Në hartimin e planeve të investimeve i licencuari duhet të bazohet dhe të respektojë:

- Kriteret e planifikimit dhe të zhvillimit të sistemit të shpërndarjes të përcaktuar në Kodin e Shpërndarjes, si dhe procedurat e parashikuara në kapitullin 2 të Kodit të Shpërndarjes (Planifikimi).
- Studimi i ngarkesave ekzistuese dhe parashikimi i zhvillimit të ngarkesave në të ardhmen.
- Informacionet dhe të dhënat e siguruara nga OST-ja, pjesëmarrësit e tregut dhe klientët kryesorë të lidhur me sistemin e shpërndarjes.
- Kriteret e projektimit të elementeve kryesore të rrjetit të shpërndarjes (nënstacione, kabina transformimi, linja shpërndarëse të TM dhe TU etj.).
- Periudha kohore e zbatimit të investimit për ndërtimin apo rehabilitimin e një objekti.

3. Në planin e investimeve të parashikuara, i licencuari duhet të pasqyrojë listën e projekteve, që do të zbatojë.

4. Plani i investimeve shoqërohet me relacione argumentuese lidhur me:

a) Metodologjitë e ndjekura për parashikimin e kërkesës, ngarkesës dhe ngarkesës pik sipas kushtit n-1 duke i paraqitur ato në mënyrë tabelare dhe grafike, që kanë diktuar ndërtimin apo rehabilitimin e nënstacioneve (TL/TM0, kabinave të transformimit, pajisjeve rregulluese të tensionit etj.

b) Ndikimet e investimit në përmirësimin e humbjeve në rrjet dhe treguesve të tjerë të performancës etj. (Krahasimi i humbjeve para dhe pas investimit).

c) Kostot, burimet e financimit, periudhat e shlyerjes së investimeve etj.

KAPITULLI III
PROCEDURAT E PARAQITJES DHE MIRATIMIT TË PLANIT TË INVESTIMEVE

Neni 11
Procedura e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve

1. Një procedurë për miratimin e planit të investimeve fillon me paraqitjen e një kërkese për miratim të planit të investimeve nga një person mbajtës i një licence të dhënë nga ERE së bashku me një plan të detajuar investimesh, sipas dispozitave të parashikuara në nenet 8,9,10, si dhe shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

2. Nëse informacioni për planin e investimeve është dhënë konform kërkesave të përcaktuara në këtë rregullore, Bordi i Komisionerëve të ERE-s merr vendim për fillim procedure të shqyrtimit të planit të investimeve.

3. ERE, pasi shqyrton planin e investimeve dhe, nëse e gjen atë në përputhje me kërkesat e lartpërmendura, e miraton tërësisht ose pjesërisht atë.

Neni 12
Afatet e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve

1. ERE ka përcaktuar afatet për paraqitjen dhe miratimin e planit të investimeve në kontekstin e aplikimit dhe miratimit të tarifave për veprimtaritë e përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje. Të licencuarit do të paraqesin në ERE planin e investimeve për vitin pasardhës jo më vonë se data 15 korrik.

2. ERE publikon njoftimin për paraqitjen e planit të investimeve nga i licencuari jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga data e pranimit të aplikimit për marrjen e komenteve nga të interesuarit. Të interesuarit mund të paraqesin komentet e tyre brenda 15 ditëve nga publikimi.

3. ERE mund të kërkojë sqarime ose të bëjë pyetje lidhur me planin e investimeve të paraqitur nga i licencuari, nga data e paraqitjes së tij deri në fund të muajit korrik.

4. Brenda datës 10 gusht, ERE mund të organizojë seanca dëgjimore me pjesëmarrjen e palëve të interesuara.

5. ERE shqyrton dhe merr vendim për miratimin e plotë ose të pjesshëm të planit të investimeve brenda datës 20 gusht.

Neni 13
Kriteret për miratimin e planit të investimeve

1. ERE mund të miratojë planin e investimeve në tërësi ose në mënyrë të pjesshme sipas përparësisë së projekteve. Informacioni i paraqitur në planin e investimeve përdoret nga ERE për të përcaktuar bazën e rregulluar të aseteve (RAB) të veprimtarive të përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje.

2. Në miratimin e planit të investimeve, ERE merr në konsideratë:

-Nëse plani përmirëson nivelin dhe cilësinë e shërbimit.

-Nëse plani është në gjendje të përmirësojë dhe reduktojë humbjet teknike dhe joteknike.

-Nëse plani përmban dhe reflekton masat për minimizimin e kostos duke përfshirë praktikat transparente dhe të drejta të blerjeve.

-Nëse plani është mjaftueshmërisht i detajuar, i dokumentuar dhe konsiston në një shkallë të duhur fleksibiliteti në zbatim.

-Nëse plani i investimeve ka analizuar dhe vlerësuar disa alternativa dhe ka argumentuar faktin se pse alternativat e tjera nuk janë përfshirë.

-Nëse plani i investimeve është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike.

3.Nëse ERE e sheh të arsyeshme mund të kërkojë kryerjen e një oponence për vlerësimin e aspekteve teknike dhe efiçencën ekonomike të investimit.

Neni 14
Njoftimi për vendimin

1. Brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit, ERE do të njoftojë të licencuarin, si dhe do t'i dërgojë atij një kopje të vendimit.

2. Vendimi i Bordit të Komisionerëve për miratimin e planit të investimeve për të licencuarit publikohet në Fletoren Zyrtare.

3. Brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, i licencuari ka të drejtë të paraqesë ankim në ERE konform rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.

KAPITULLI IV
DISPOZITA TË TJERA

Neni 15
Informacioni konfidencial

Në rast se ndonjë i licencuar pretendon se plani i investimeve të tij përmban një numër informacionesh dhe të dhënash, që ai i konsideron konfidenciale, ai do t'i shënojë si konfidenciale kur paraqet planet e investimeve dhe të tilla informacione dhe të dhëna do të trajtohen nga ana e ERE-s, sipas rregullave dhe procedurave që aplikohen për këto lloj informacionesh dhe të dhënash.

Neni 16
Ankimi gjyqësor

Kundër vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për miratimin ose jo të planit të investimeve, i licencuari mund të bëjë ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare.

KAPITULLI V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17
Dispozitë kalimtare

Plani i investimeve për vitin 2010 do të paraqitet nga i licencuari në të njëjtën kohë me aplikimin për tarifën e vitit 2010.

Neni 18
Amendamente të rregullores

Kjo rregullore është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.
Kjo rregullore botohet në Fletoren Zyrtare.

SHTOJCA 1. TABELA E INVESTIMEVE PËR VITIN

Përshkrimi i grupit të aseteve (në përputhje me listën e llogarive)	Numri i llogarisë	Koha e vënies në punë	Vlera e kapitalizuar (për t'u përfshirë në RAB)	Jetëgjatësia e pritshme	Amortizimi vjetor i pritshëm

VENDIM
Nr.63, datë 22.9.2009

PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TË VENDOSURA NGA ERE SHOQËRISË E-VENTO SRL ALBANIA SHPK

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, germa "a", dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.09.2009, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë: E-Vento Srl Albania sh.p.k,

Dhe duke konsideruar :
Kompleksitetin e problematikës që i licencuari ka hasur për kryerjen dhe dorëzimin e studimit të fizibilitetit të bazuar në matje reale dhe duke qenë se ndërtimi dhe instalimi i parqeve eolik, përveç etapave administrative në të cilat kalon çdo projekt, përbën akoma një teknologji jo shumë të njohur në vend dhe që kërkon asistencën teknike të huaj,

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 12 muaj duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, afatet e përcaktuara në pikën 1, germa "a" dhe "d" të vendimit nr.84, datë 17.7.2008 "Për licencimin e shoqërisë E-Vento Srl Albania sh.p.k.".
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.64, datë 22.9.2009

PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TË VENDOSURA NGA ERE SHOQËRISË UNION EOLICA ALBANIA SHPK

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, germa "a", dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të Ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.09.2009, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqerisë Union Eolica Albania sh.p.k,

Dhe duke konsideruar:

Kompleksitetin e problematikes që i licencuari ka hasur për kryerjen dhe dorëzimin e studimit të fizibilitetit të bazuar në matje reale dhe duke qenë se ndërtimi dhe instalimi i parqeve eolik, përveç etapave administrative në të cilat kalon çdo projekt, përbën akoma një teknologji jo shumë të njohur në vend dhe që kërkon asistencën teknike të huaj,

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 12 muaj, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, afatet e përcaktuara në pikën 1, germa "a" dhe "d" të vendimit nr.88, datë 6.8.2008 "Për licencimin e shoqërisë Union Eolika Albania sh.p.k.".
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.65, datë 22 .9.2009

PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TE VENDOSURA NGA ERE SHOQËRISË HERA SHPK

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, germa "a", dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.09.2009, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë HERA sh.p.k.,

Dhe duke konsideruar :

Kompleksitetin e problematikës që i licencuari ka hasur për kryerjen dhe dorëzimin e studimit të fizibilitetit të bazuar në matje reale dhe duke qenë se ndërtimi dhe instalimi i parqeve eolik, përveç etapave administrative në të cilat kalon çdo projekt, përbën akoma një teknologji jo shumë të njohur në vend dhe që kërkon asistencën teknike të huaj,

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 12 muaj, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, afatet e përcaktuara në pikën "1" dhe "4" të vendimit nr.61, datë 2.11.2007 "Për dhënien e licencës për ndërtim, instalim dhe shfrytëzim të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale HERA sh.p.k. (Projekti KAPPET)", të ndryshuar me vendimin nr.93, datë 6.08.2008 "Për një ndryshim në vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.61, datë 2.11.2007 "Për dhënien e licencës për ndërtimin e centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike".

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit te Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 20.10.2009
Doli nga shtypi më 22.10.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 36 lekë